



REAGIM I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SOT (E SHTUNË) NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË KOSOVËS DO TË ZHVILLOHET VOTIMI PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E KOSOVËS

TË DIELËN, KOSOVA VOTON SËRISH PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE

FAQE 4-5



Të dielën, qytetarët e Kosovës do t'u drejtohen sërish kutive të votimit për zgjedhjet parlamentare, në një proces vendimtar që pritet të përcaktojë përbërjen e re të Kuvendit dhe drejtimin politik të vendit për vitet e ardhshme. Kosova ka mbajtur zgjedhjet e rregullta parlamentare më 9 shkurt 2025, por për shkak të mungesës së vullnetit politik, procesi i konstituimit të Kuvendit u prolongua për muaj të tërë që më pas rezultoi me dështimin për të formuar Qeverinë dhe institucione funksionale. KQZ-ja ka njoftuar se janë bërë të gjitha përgatitjet për këtë proces zgjedhor, derisa sot (e shtunë) në përfaqësitë diplomatike të Kosovës do të zhvillohet votimi për zgjedhjet e 28 dhjetorit

PA PRANINË E TË BIRIT "CALIT", VARROSET BABAI I SALIH MUSTAFËS

F. 3



SHËNDETI NË OKUK PRET, PAVARËSISHT INVESTIMEVE MILIONËSHE

F. 6



AKTUALE



ZELENSKY THOTË SE DO TË TAKOHET ME TRUMPIN PËR TË DISKUTUAR PROPOZIMIN PËR PAQE

F. 2

IKSHPK-ja PARALAJMËRON RRIJJE TË RASTEVE ME GRIP, APEL PËR VAKSINIM SEZONAL

F. 6

SLLAGJAN TRAJKOVIC DËNOHET ME DHJETË VJET BURGIM PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË

F. 7

EKONOMI



SËRISH PROBLEME ME RRYMËN: PSE NUK PO STABILIZOHET SITUATA NË KOSOVË?

F. 8

ZRRE U BËN THIRRJE QYTETARËVE DHE BIZNESEVE PËR KUJDES NË PËRDORIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

F. 8

SPORT



DUKA: DUHET TA KEMI NJË KOMBËTARE

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ZELENSKY THOTË SE DO TË TAKOHET ME TRUMPIN PËR TË DISKUTUAR PROPOZIMIN PËR PAQE

UASHINGTON, 26 DHJETOR - Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, tha më 26 dhjetor se është pajtuar që të takohet me presidentin amerikan, Donald Trump, “në një të ardhme të afërt”, teksa Uashingtoni po përshpejton përpjekjet për të ndërmjetësuar një marrëveshje të paqes mes Kievit dhe Moskës.

Zelensky njoftoi për takimin e planifikuar përmes rrjeteve sociale, duke thënë se ka pranuar një raport nga sekretari i Këshillit Kombëtar për Siguri dhe Mbrojtje, Rustem Umerov, lidhur me kontaktet e reja me zyrtarët amerikanë. “Nuk po e humbasim asnjë ditë. Jemi pajtuar për një takim të nivelit më të lartë - me presidentin Trump, në një të ardhme të afërt”, tha Zelensky, duke shtuar se “shumë mund të vendoset para Vitit të Ri”.

Trump nuk ka konfirmuar publikisht një takim të tillë. Zelensky pritet të udhëtojë drejt Floridës më 28 dhjetor për bisedime të nivelit të lartë në Mar-a-Lago, thanë burimet për Kyiv Post.

Njoftimi vjen një ditë pasi Zelensky tha se kishte zhvilluar një bisedë telefonike me të dërguarit e Trumpit, Steve Witkoff dhe Jared Kushner, për të diskutuar “idetë e mira për

një paqe të qëndrueshme”. Sipas Zelenskyt, në bisedë morën pjesë edhe Umerov, shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura, Andriy Hnатов, dhe ministri i Jashtëm, Andriy Sybiha. “Diskutuam për disa detaje kyç të punës. Ka ide të mira që mund të ndihmojnë në arritjen e një rezultati të përbashkët dhe një paqe të qëndrueshme. Siguria e vërtetë, rimëkëmbja e vërtetë dhe paqja e vërtetë - këto janë ato që na duhen”, shkroi Zelensky.

Këto zhvillime vijnë në kohën kur negociatorët amerikanë, ukrainas dhe evropianë po punojnë mbi një kornizë për paqe me 20 pika, që synon t'i japë fund luftës mes Ukrainës dhe Rusisë.

Plani, i shpalosur nga Zelensky më herët gjatë javës, përfshin pika për garanci të sigurisë për Ukrainën, rindërtimin dhe një udhëzuesi për ndaljen e armiqësive. Përfaqësues nga Rusia morën po ashtu pjesë në diskutimet e organizuara nga ShBA-ja në Majami më 20-21 dhjetor, megjithëse Kremlinin më pas tha se këto bisedime nuk mund të shihen si ndonjë përparim i madh.

Bloomberg, duke cituar një burim të afërt me Kremlinin, raportoi se Moska synon të kërkojë ndryshime në planin aktual me 20-pikësh për të



marrë garanci të sigurisë kundër zgjerimit të mëtejshëm të NATO-s në lindje dhe për të garantuar që Ukraina do të mbajë status neutral nëse anëtarësohet në Bashkimin Evropian.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, konfirmoi se presidenti rus, Vladimir Putin, është informuar mbi bisedimet në Majami dhe se Rusia planifikon të vazhdojë kontaktet me Uashingtonin lidhur me qëndrimin e saj gjatë ditëve në vijim.

Ndërkohë, sipas zyrtarëve ukrainas, Rusia ka vazhduar të sulmojë Ukrainën ditët e fundit, duke përshkallëzuar sulmet në rajonin jugor të Odesës.

Forcat ruse kanë lëshuar një

raketë Iskander-M dhe 99 dronë sulmues mbi Ukrainë gjatë natës, sipas Forcave Ajrore të Ukrainës. “Sot, armiku sulmoi përsëri qytetin tonë”, tha më 26 dhjetor Serhiy Lysak, kreu i administratës ushtarake të Odesës, duke shtuar se një sulm me dronë goditi një objektiv infrastrukturor në qytet, duke shkaktuar zjarr.

Sulmet ruse të kryera gjatë natës dëmtuan anije të regjistruara në Sllovaki, Palau dhe Liberi, në portet në Odesa dhe Mikolajiv në Ukrainë, sipas zëvendëskryeministrit ukrainas, Oleksiy Kuleba.

Një grup i senatorëve amerikanë, nga të dyja partitë, dënoi sulmet e Rusisë ndaj

civilëve ukrainas gjatë festës së Krishlindjes. “Ne dënojmë sulmet brutale të Rusisë ndaj Hersonit, Çernihivit, Harkivit, Odesës, Sumit, Donjeckut dhe Krivi Rihut kundër ukrainasve të pafajshëm”, u tha në deklaratën e publikuar më 25 dhjetor. “Edhe për vendet që janë në luftë, ekziston një histori e gjatë e armëpushimeve gjatë Krishtlindjes, veçmas gjatë Luftës së Parë Botërore. Vendimi i sotëm i Putinit për të kryer sulme në vend që të ketë një armëpushim është një tregues për të gjithë ne se Putini është një vrasës mizor që nuk ka interes në paqe dhe nuk mund t'i besohet”, u tha në këtë deklaratë.

SHBA-ja KRYEN SULME NDAJ IS-it NË NIGERI

UASHINGTON, 26 DHJETOR - Presidenti Donald Trump tha se forcat amerikane kanë kryer sulme “të fuqishme dhe vdekjeprurëse” të enjten ndaj grupit ekstremist, Shteti Islamik, në veriperëndim të Nigerisë, disa javë pasi paralajmëroi kundër çdo sulmi sistematik ndaj të krishterëve në këtë shtet.

Ministria e Punëve të Jashtme e Nigerisë të premten konfirmoi sulmet ajrore, duke i përshkruar ato si “goditje precize ndaj objektivave terroriste” në vend. Pak detaje janë dhënë për sulmet dhe është e paqartë se sa njerëz janë vrarë.

Trump tha se ai “paraprakisht kam paralajmëruar këta terroristë se nëse nuk ndalojnë masakrimin e të krishterëve, ata do të përballen me ferr dhe sonte ata u përballën”. “Gëzuar Krishtlindja të gjithëve, përfshirë terroristëve të vrarë dhe të tillë do të ketë edhe më shumë nëse vazhdon masakrimi i të krishterëve”, shkroi ai në rrjetin e tij social, Truth Social. Zyrtarët amerikanë të mbrojtjes më pas postuan një video që duket se shfaq një sulm me



raketa të kryer gjatë natës nga një luftanije.

Ky ishte sulmi i parë i kryer nga forcat amerikane në Nigeri gjatë presidencës së Trumpit dhe vjen pasi udhëheqësi amerikan në tetor dhe nëntor tha se të krishterët po përballen “me krizë ekzistenciale” që përbën “gjenocid”, teksa ky shtet i Afrikës Perëndimore po përballlet me konflikte të armatosura.

Qeveria e Nigerisë dhe analistët e pavarur refuzojnë të përshkruajnë tensionet si

persekutim fetar.

Por Trump, duke vënë në pah atë që administrata e tij e quan persekutim global të të krishterëve, theksoi muajin e kaluar se Uashingtoni është i gatshëm të ndërmarrë veprime ushtarake në Nigeri për të kundërshtuar këto vrasje.

Ministria e Jashtme e Nigerisë tha se vendi është i angazhuar me partnerët ndërkombëtar. “Autoritetet nigeriane mbeten të angazhuara në bashkëpunim të strukturuar të sigurisë me

partnerë ndërkombëtarë, përfshirë ShBA-në, për t'u përballur me kërcënimin e vazhdueshëm të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm”, tha kjo ministri.

Shefi i Pentagonit, Pete Hegseth, përmes një postimi në X tha se ishte “mirënjohës për mbështetjen dhe bashkëpunimin e Qeverisë nigeriane”.

ShBA-ja këtë vit e riktheu Nigerinë në listën e vendeve me “shqetësim të veçantë” sa i përket lirisë fetare dhe ka kufizuar

lëshimin e vizave për shtetasit nigerianë.

Muajin e kaluar, Trump kërcënoi me ndaljen e plotë të ndihmave për Nigerinë nëse “vazhdon të lejojë vrasjen e të krishterëve”.

Nigeria është pothuajse e ndarë në mënyrë të barabartë me shumicën myslimane që jeton në veri dhe në jugun e banuar kryesisht me të krishterë.

Verilindja e vendit prej më shumë se 15 vjetësh përballet me dhunën e grupit islamist Boko Haram, dhunë që ka lënë të vdekur më shumë se 40 mijë persona dhe ka detyruar 2 milionë të tjerë që të zhvendosen.

Po ashtu, pjesë të mëdha të veriperëndimit, veriut dhe pjesës qendrore të Nigerisë janë goditur nga banda kriminale të njohura si “banditë”, të cilat sulmojnë fshatra, duke vrarë dhe rrëmbyer banorë.

Të mërkurën, një shpërthim goditi një xhami në Maiduguri, në verilindje të Nigerisë, duke vrarë të paktën shtatë besimtarë. Asnjë grup i armatosur nuk e ka marrë përgjegjësinë për këtë sulm.

PA PRANINË E TË BIRIT ‘CALIT’, VARROSET BABAI I SALIH MUSTAFËS

PODUJEVË, 26 DHJETOR - Babai i ish-komandantit të UÇK-së, Salih Mustafa, është varrosur të premten në fshatin Rimanishtë të Prishtinës, në një ceremoni mortore të mbajtur në prani të familjarëve, të afërmeve, qytetarëve të shumtë dhe në prezencën e ish-luftëtarëve të UÇK-së dhe udhëheqjes së OVLUÇK-së.

Në varrim nuk ka qenë i pranishëm i biri i tij, Salih Mustafa, të cilit iu mohua e drejta nga Gjykata Speciale për ta vizituar babanë sa ishte i sëmurë në gjendje të rënduar, madje kjo nuk iu mundësua as për t’ia dhënë lamtumirën e fundit.

Mungesa e ish-komandantit të UÇK-së, Salih Mustafa - Cali, në varrimin e babait të tij, Jahja Mustafa, ka rënduar

edhe më shumë dhimbjen e familjes së tij, miqve dhe bashkëluftëtarëve.

Cali, ish-pjesëtar i UÇK-së, po vuan dënimin me 15 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë.

Të premten në ceremoninë e varrimit të Jahja Mustafës, Hysni Gucati, kryetar i OVLUÇK-së ka theksuar se pavarësisht dhimbjes, familja do të gjejë forcë për të përballuar këtë humbje, megjithatë ai i kritikoi ashpër Dhomat e Specializuara në Hagë, për moslejimin e vizitës humanitare për ish-pjesëtarin e UÇK-së, Salih Mustafa - Cali. “Unë e di që Cali mes dhimbjes do ta gjejë edhe forcën. Ne e dimë që kjo gjykatë është shumë e dëmshme për vendin, dhe ishte dashur që kjo gjykatë ta



lejojë Calin që të vijë në vizitë humanitare. Para pesë ditësh ne kemi bërë kërkesë dhe mbrojtja e Calit ka bërë kërkesë që ta lirojë Calin që të vijë të paktën ta vizitojë babanë sa ishte në spital gjallë dhe ndodhi e kundërta. Sot nuk e liruan dhe unë kam menduar që të paktën sot do ta lirojnë në varrim, sepse Cali ishte i dënuar me verdikt 15 vite burgim padrejtësisht, i dënuar me dëshmitarë të rrejshëm dhe të falsifikuar. Prej kësaj qeverie nuk presim asgjë. Kjo qeveri është për turpin e shqiptarëve që është në pushtet”, u shpreh ai.

Valon Murati, mik i Salih Mustafës, ka thënë se mungesa e Calit në varrimin e babait e rëndon dhimbjen edhe më shumë, pasi që sipas

tij, është dënuar nga Dhomat e Specializuara padrejtësisht dhe për këtë arsye nuk është i pranishëm. “Dhimbja sot është e trefishtë, është e trefishtë, sepse po e humbim bacën Jahë, pra po e humbim një njëri të dashur, një njëri që ka dhënë kontribut, një njëri që ka qenë shpi e madhe e lirisë së Kosovës. Po ndjejmë dhimbje edhe që nuk e kemi Calin këtu, pra është një dhimbje e dyfishtë. E kemi djalin e tij shokun tonë të dashur, një nga njerëzit me kontribuues për lirinë që kemi sot. Por e kemi edhe një dhimbje tjetër, sepse ai nuk është këtu për shkak një padrejtësie të madhe që po na shkaktohet. Është kjo padrejtësi e cila dhimbjen e bënë edhe më të

madhe. Cali nuk është këtu, sepse është i dënuar në mënyrë të padrejtë fatkeqësisht nga një gjykatë e padrejtë, e cila flet në emër tonin por nuk vepron në emrin tonë”, theksoi ai.

Babai i Salih Mustafës, Jahja Mustafa ka ndërruar jetë të dielën.

Salih Mustafa - Cali, ish-pjesëtar i UÇK-së, po vuan dënimin me 15 vjet burg nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Pas vdekjes së babait të tij, familjarë dhe bashkëluftëtarë kanë reaguar ashpër ndaj kësaj gjykate për moslejimin e vizitës humanitare dhe pjesëmarrjes së tij në varrim, duke e cilësuar këtë si padrejtësi dhe mungesë ndjeshmërie humane.



REAGIM I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

GJYKATA RACISTE SPECIALE!

Kush ka menduar se ka ikur koha e inkuizicionit, del se ka gabuar shumë. GjRS - Gjykata Raciste Speciale është rimishërim i inkuizicionit në zemër të Ev(u)ropës ku brutalisht shkelet dinjiteti i njeriut të privuar nga liria, ku pafund shkelen të drejtat e njeriut dhe humanizmi është kthyer në gjykim të shpellave, në kanibalizëm juridik. Me paradoksin se në vendin e iluminizmit kemi terr informativ, mungesë të drejtave themelore të njeriut nga burokratët juridikë ndërkombëtarë . Të zhveshur nga çdo e drejtë, pengjet e inkuizicionit në Burgun e Hagës, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës po kalojnë kalvarin shpirtëror nga kriminelët juridikë të Hagës dhe rrogëtarët e tyre politikë në Prishtinë të shpërfytyruar si Kurti, Haxhiu, Sfeqla, Basha, Murati, Shvarc, Osmani dhe Mihali.

Institucionet e Kosovës

brutalisht ndërhyjnë në të gjitha nivelet e gjyqësorit ndërsa sa i përket GjRS - Gjykatës Speciale Raciste e kanë luajtur lojën e struçit, kanë folur me gjuhën e peshkut! Askush nuk ka kërkuar që ato të ndërhyjnë në drejtësi por se ka qenë detyrim ligjor të sigurojnë transparencë dhe llogaridhënie, të kërkojnë një proces të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar nga politika, parapolitika dhe grupet e intetesit. Kanë pasur detyrim ligjor të kërkojnë monitorim të pavarur e jo që nuk e kanë bërë por e kanë penguar. Kanë pasur detyrim ligjor të sigurojnë mbrojtje cilësore juridike ndërkaq këta e kanë pakësuar këtë mbrojtje përmes pakësimit të fondeve dhe kufizimeve tjera. Sjellja jonjerëzore e GjRS - Gjykatës Raciste Speciale ndaj Salih Mustafës - Calit ishte provuar edhe në rastet e Hysni Gucatit, Nasim Haradinajt, Pjetër Shalës, Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit.



Heshtja e institucioneve e ka përligjur diskriminimin e Gjykatës Raciste Speciale ndaj pengjeve të Hagës, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës, udhëheqës të luftës, ndërtues të shtetit dhe të paqes si dhe bartës më të larta të posteve shtetërore në Kosovë. Moslejimi i vizitës së Salih Mustafës - Calit është pafytyra e

fytyrës së shëmtuar të kësaj gjykate në aspektin e detyrimit të respektimit të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria e që garantohen nga Rregullat Evropiane të Burjeve, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara dhe, mendermethënë Rregullat e Nelson Mendelës si

standardi më i lartë i këtyre të drejtave. Ndonëse deklarohet si Gjykatë e Kosovës, Gjykata Raciste Speciale Kushtetutën e Kosovës e injoron deri në poshtërim. Avokatin e Popullit të Kosovës nuk e trajton si institucion shtetëror por si familjarë i personave të privuar nga liria.

Babai i Salih Mustafës ndërroi jetë pa e takuar të birin që u dënua në sajesa të Serbisë dhe dëshmitar të Ministrisë së Drejtësisë.

Me moslejimin e vizitës së Salih Mustafës babait të sëmurë rëndë e që ndërroi jetë u dëshmuar rrënimi moral i GjRS si dhe institucioneve të Kosovës.

Në të gjitha shtetet dhe vendet e botës respekti ndaj vlerave të luftës dhe sakrifikesve për liri është themel mbi të cilin ngrihen të gjitha vlerat tjera. Te ne është e kundërta, antivlerat dhe antikombëtarët ,mbajnë poste të larta shtetërore ndërsa vlerat e vërteta janë të marginalizuara ose në burg.



SOT (E SHTUNË) NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË KOSOVËS DO TË ZHVILLOHET VOTIMI PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E KOSOVËS

TË DIELËN, KOSOVA VOTON SËRISH PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Të dielën, qytetarët e Kosovës do t'u drejtohen sërish kutive të votimit për zgjedhjet parlamentare, në një proces vendimtar që pritet të përcaktojë përbërjen e re të Kuvendit dhe drejtimin politik të vendit për vitet e ardhshme. Kosova ka mbajtur zgjedhjet e rregullta parlamentare më 9 shkurt 2025, por për shkak të mungesës së vullnetit politik, procesi i konstituimit të Kuvendit u prolongua për muaj të tërë që më pas rezultoi me dështimin për të formuar Qeverinë dhe institucione funksionale. KQZ-ja ka njoftuar se janë bërë të gjitha përgatitjet për këtë proces zgjedhor, derisa sot (e shtunë) në përfaqësitë diplomatike të Kosovës do të zhvillohet votimi për zgjedhjet e 28 dhjetorit

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Më 27 dhjetor 2025, në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, do të zhvillohet votimi për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Të gjitha qendrat e votimit hapen në orën 07:00 dhe do të mbyllen në orën 19:00, sipas kohës lokale të çdo shteti. Vetëm 19,187 votuesit e regjistruar në 29 përfaqësi diplomatike do të mund të votojnë më 27 dhjetor 2025, pasi në listën votuese, e cila do të përdoret në këto përfaqësi diplomatike, janë vetëm emrat

e shtetasve që kanë përzgjedhur këtë mënyrë votimi kur janë regjistruar si votues jashtë Kosovës gjatë periudhës së regjistrimit (26 nëntor - 6 dhjetor 2025). Procesi i votimit do të zhvillohet në 40 vendvotime që u përkasin 16 ambasadave dhe 13 konsullatave të Republikës së Kosovës, të cilat janë të vendosura në 18 shtete të ndryshme. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka akredituar 19 085 vëzhgues, të cilët përfaqësojnë: subjekte politike të certifikuara, organizata joqeveritare vendore, organizata ndërkombëtare, m e d i a

vendore/ndërkombëtare, institucione shtetërore dhe përfaqësi diplomatike. KQZ-ja tashme ka certifikuar e Listës Votuese për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Sipas të dhënave nga kjo listë, numri i shtetasve të Kosovës me të drejtë vote në këtë proces zgjedhor është: 2,076,290 votues. Sipas të dhënave nga Lista Votuese, numri i qytetarëve me të drejtë vote në vendvotime, në Republikën e Kosovës është 1,999,205 votues, ndërkaq numri i qytetarëve që janë regjistruar për të votuar jashtë Kosovës është 77,085 votues. Kjo listë përmban 7,192 votues më shumë se në zgjedhjet

lokale të cilat u mbajtën më 12 tetor 2025. Procesi zgjedhor brenda vendit do të zhvillohet në 948 Qendra të Votimit, me gjithsej 2,614 vendvotime, prej të cilave 910 qendra me 2,557 vendvotime për votimin e rregullt dhe 38 qendra, nga një për çdo komunë, me 57 vendvotime për të mundësuar votimin me kusht. Fletëvotimi në këto zgjedhje përmban 24 subjektet politike pjesëmarrëse në këtë proces zgjedhor, prej të cilave, 18 parti politike, 3 koalicionet, 2 iniciativa qytetare dhe 1 kandidat i pavarur. Numri i përgjithshëm i kandidatëve që përfaqësojnë këto subjekte politike është 1,181 kandidatë.

Rreth 100 prokurorë do të angazhohen për zgjedhjet e 28 dhjetorit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka njoftuar se për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen të dielën më 28 dhjetor 2025, Prokurori i Shtetit ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për të realizuar mbrojtjen e votës së lirë të qytetarëve, duke

garantuar integritetin e procesit zgjedhor. Në këto zgjedhje janë angazhuar së bashku rreth 100 prokurorë të shtetit dhe zyrtarë të sistemit prokurorial, të cilët do të qëndrojnë kujdestarë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, deri në përfundim të procesit zgjedhor, me qëllim të procedimit të çdo parregullsie që mund të ndodhë në këto zgjedhje. Prokurori i Shtetit i fton qytetarët e Republikës së Kosovës, të gjitha subjektet politike, institucionet apo organizatat e ndryshme, që të denoncojnë tek prokuroritë përkatëse, çdo rast, për të cilin kanë dyshime se po keqpërdoret ose manipulohet vota në çfarëdo mënyre dhe nga kushdo qoftë.

Programet partiake pa qasje gjithëpërfshirëse për qeverisje të mirë dhe sundim të ligjit

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin krahasues dhe analizues mbi programet politike të partive kryesore pjesëmarrëse në zgjedhjet e jashtëzakonshme

parlamentare të 28 dhjetorit, me fokus në qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë se në çfarë mase dhe në çfarë mënyre programet politike adresojnë çështjet kyçe që ndërlidhen me qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, duke ofruar një pasqyrë objektive dhe të matshme për qytetarët që do të votojnë në zgjedhjet e 28 dhjetorit. Raporti nuk vlerëson oportunitetin apo përshtatshmërinë politike të masave të propozuara, por fokusohet ekskluzivisht në shtrirjen, nivelin e elaborimit dhe strukturimin e angazhimeve programore, në raport me indikatorët e paracaktuar dhe të aplikuar në mënyrë uniforme në raport me programet e katër (4) partive politike. Indikatorët janë ndërtuar mbi bazën e parimeve të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit si dhe problemeve të identifikuara ndër vite përmes raporteve vendore, ndërkombëtare, raportet dhe analizat e IKD etj.

Gjatë prezantimit të raportit u theksua se asnjë nga programet politike të partive pjesëmarrëse nuk ofron një qasje gjithëpërfshirëse, të strukturuar dhe të matshme për avancimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit. Hulumtuesi i lartë i IKD-së, Gzim Shala, ka thënë se raporti nuk vlerëson përshtatshmërinë politike apo adekuatshmërinë e zgjidhjeve të propozuara nga partitë, por fokusohet në nivelin e elaborimit, strukturimit dhe konkretizimit të angazhimeve programore. “Vlerësimi është bërë mbi një metodologji të njëjtë dhe uniforme për të gjitha programet politike”, ka potencuar Shala, duke shtuar se raporti analizon se sa masat e propozuara janë të prezantuara në mënyrë të qartë, të strukturuar, të buxhetuara dhe të përcaktuara me afate kohore. Sipas tij, vlerësimi është realizuar përmes dhjetë indikatorëve, të ndarë në dy shtylla kryesore: qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. Në kuadër të qeverisjes

së mirë janë vlerësuar barazia gjinore, transparencja dhe llogaridhënia, depolitizimi i administratës publike, dixhitalizimi dhe pavarësia e mediave. Ndërsa, indikatorët që lidhen me sundimin e ligjit përfshijnë reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit, integritetin në fushën e prokurimit publik, vettingun në drejtësi dhe të drejtat e njeriut. “Rezultatet e vlerësimit tregojnë se asnjë nga programet politike nuk ofron një qasje gjithëpërfshirëse, të strukturuar dhe të matshme për avancimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit”, ka deklaruar Shala, duke shtuar se në shumicën e rasteve angazhimet mbesin në nivel të përgjithshëm ose deklarativ, pa masa konkrete dhe pa afate kohore. Ai ka theksuar se gjetjet në fushën e sundimit të ligjit janë veçanërisht shqetësuese, pasi programet nuk ofrojnë vizione të qarta për reformën në sistemin e drejtësisë, ndërsa vettingu në drejtësi nuk përmendet në programet e

asnjërës nga katër partitë më të mëdha. Sa i përket poentimit të përgjithshëm, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka marrë vlerësimin më të lartë me 13 pikë nga 50 të mundshme, e ndjekur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 11 pikë, Lëvizja Vetëvendosje! (LV) me 9 pikë, ndërsa Partia Demokratike e Kosovës (PDK) renditet e fundit me 6 pikë. Shala theksoi se diferencat në poentim ndërmjet partive janë relativisht të vogla dhe nuk pasqyrojnë plane të mirëfillta reformuese. “Këto diferenca reflektojnë më shumë përfshirjen ose mungesën e trajtimit të disa indikatorëve specifikë, sesa ekzistencën e qasjeve të qarta dhe të strukturuar reformuese”, është shprehur ai. Drejtori ekzekutiv i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka thënë se partitë politike nuk i japin rëndësinë e duhur proceseve që lidhen me të ardhmen e vendit dhe integrimin evropian, pasi këto çështje

mungojnë ose trajtohen në mënyrë sipërfaqësore në programet e tyre politike. “Partitë politike nuk kanë ofruar programe përmbajtjesore, parime apo objektiva të qarta lidhur me vettingun, Strategjinë për Sundimin e Ligjit, funksionimin demokratik të institucioneve kushtetuese, luftën kundër korrupsionit, qeverisjen me duar të pastra apo konfliktin e interesit”, ka theksuar Miftaraj. Ai shtoi se mungesa e këtyre angazhimeve programore e bën të vështirë matjen e punës së partive politike në rast të ardhjes së tyre në pushtet. “Nëse nesër duam ta matim punën e tyre bazuar në programet politike, atëherë mund të themi se ato nuk kanë obligime konkrete, sepse shumë nga çështjet e trajtuara në raport nuk janë pjesë e programeve të tyre. Prandaj, puna e tyre mbetet për t’u matur me deklaratimet në debate televizive dhe premtimet e bëra gjatë fushatës zgjedhore”, ka thënë Miftaraj.



Kosova mbajti zgjedhjet e rregullta parlamentare më 9 shkurt, por dështuan në formimin e qeverisë

Kosova ka mbajtur zgjedhjet e rregullta parlamentare më 9 shkurt 2025, por për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe ndarjeve të mëdha mes partive politike, mosrespektimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga fituesja e këtyre zgjedhjeve LV-

ja, procesi i konstituimit të Kuvendit u prolongua për muaj të tërë që më pas rezultoi me dështimin për të formuar Qeverinë dhe institucione funksionale. Tentativat e përsëritura për konstituimin e Kuvendit u shoqëruan me kontestime

politike, juridike, duke rezultuar në një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese që përcaktuan parametrat kushtetues të këtij procesi. Pas krizës disa mujore institucionale dhe dështimit për përzgjedhjen e Qeverisë,

Presidentja e Republikës së Kosovës shpërndau Kuvendin dhe shpalli zgjedhjet e jashtëzakonshme më 28 dhjetor 2025. Në këtë kontekst institucional të tejzgjatur dhe në mungesë të qeverisjes funksionale, programet politike të partive

marrin një rëndësi të posaçme, pasi ato paraqesin orientimet e tyre qeverisëse, angazhimet publike dhe pritshmëritë që i ofrohen qytetarëve. Ato përbëjnë dokumentin kryesor përmes të cilit partitë politike paraqesin ofertën e tyre ndaj qytetarëve.


SHËNDETI NË QKUK PRET, PAVARËSISHT INVESTIMEVE MILIONËSHE

Në Klinikën e Kardiologjisë në QKUK, aktualisht, janë rreth 2 mijë pacientë në pritje për koronarografi dhe vendosjen e stentave. Gjatë viteve të fundit, janë realizuar investime në QKUK, përfshirë rinovime, shtretër të rinj dhe aparatura të avancuara, por ato duket se nuk kanë ulur ndjeshëm listat e pritjes. Problemet thuhet se nuk burojnë vetëm nga mungesa e resurseve, por kryesisht nga menaxhimi joefikas i kapaciteteve ekzistuese

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Dy ditë në javë, korridoret e Klinikës së Kardiologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) mbushen me dhjetëra pacientë që presin një vendim mjekësor me rëndësi jetike për ta - nëse do t'u kryhet koronarografia apo do t'u vendoset stenti. Përpara tyre është një komision i përbërë nga mjekë dhe infermierë, i cili shqyrton dokumentacionin mjekësor, analizat dhe, kur është e nevojshme, kërkon ekzaminime shtesë, para se pacientët të përfshihen në listat e pritjes. Koronarografia shërben për të identifikuar ngushtimet ose bllokimet në arteriet që furnizojnë zemrën me gjak, ndërsa stenti është një tub i vogël metalik që vendoset për të mbajtur arteriet e hapura dhe për të rikthyer qarkullimin normal të gjakut. Sipas stafit të Klinikës së Kardiologjisë, aktualisht janë rreth 2 mijë pacientë që presin për këto shërbime, përfshirë edhe raste të regjistruara në muajt e parë të vitit 2024. Një nga arsyet kryesore të këtij grumbullimi, sipas mjekëve dhe infermierëve me të cilët bisedoi REL-i, është mosfunksionimi i disa aparaturave për së paku dy muajt gjatë këtij viti. Ngarkesën e ka shtuar edhe fluksi i madh i pacientëve nga komunat e Kosovës, përfshirë ato ku më herët janë kryer ekzaminime të tilla, si dhe numri i madh i referimeve nga klinikat e tjera brenda QKUK-së. Stafi, megjithatë, siguron se rastet urgjente trajtohen menjëherë dhe nuk mbeten në listat e pritjes.

“Kam më shumë se një vit që pres”

R. Shala nga Mitrovica e Jugut ishte më 18 dhjetor në mesin e pacientëve që prisnin në korridoret e Kardiologjisë për një termin për vendosjen e stentit. “I kam vendosur 12 stenta - njëherë katër, njëherë gjashtë dhe njëherë dy. Katër i kam vendosur në spital privat, të tjerat këtu, në QKUK. Terminin për koronarografi e kam bërë para më shumë se një viti dhe ende nuk më kanë thirrur. Erdha të interesohem, sepse kam probleme dhe nuk jam mirë”, tha Shala për Radion Evropë e Lirë, teksa mbante një grumbull dokumentesh në duar. Edhe pacientë të tjerë thanë se nuk kishin marrë një datë të saktë për procedurën. “Jo, nuk më caktuan datë. Vetëm më thanë se do të më thërrasin në telefon”, tha një burrë në të 40-at. Në Klinikën e Kardiologjisë punojnë rreth 40 kardiologë, prej të cilëve afërsisht 12 janë kardiologë invazivë. Ata kryejnë ekzaminime për identifikimin e ngushtimeve dhe bllokimeve në arteriet e zemrës, ndërhyrje për hapjen e arterieve të bllokuara, si dhe vendosjen e stentave. Sipas të dhënave të klinikës, çdo ditë realizohet 10 deri në 13 koronarografi. Këto procedura kryhen edhe në disa spitale private në Kosovë, por janë ndjeshëm më të kushtueshme krahasuar me sektorin publik.



Investime pa efekt në zvogëlimin e listave të pritjes

Gjatë viteve të fundit, në QKUK janë realizuar investime në disa klinika, përmes fondeve qeveritare dhe donacioneve. Për shembull, në Klinikën e Kardiokirurgjisë, për renovim, shtretër dhe hapësira të reja janë investuar vitin e kaluar 750 mijë euro, ndërsa në Klinikën Emergjente rreth 800 mijë euro. Janë siguruar edhe aparatura të reja, përfshirë skanerin PET/CT për herë të parë, për diagnostikimin dhe menaxhimin e llojeve të ndryshme të kancerit dhe disa sëmundjeve të tjera. Në Klinikën e Kardiologjisë, sipas mjekëve, investimet kanë qenë kryesisht infrastrukturore, pa blerje të pajisjeve të reja. Megjithatë, ata thonë se materialet dhe barnat janë të mjaftueshme dhe se pacientët nuk kanë nevojë t'i sigurojnë vetë.

Pritje të gjata edhe në klinika të tjera

Problemi i listave të pritjes nuk kufizohet vetëm në Kardiologji. Në Klinikën e Ortopedisë, pavarësisht ndërtimit të një objekti të ri dhe rinovimeve, pritja për një protezë gjuri mund të zgjasë mbi tre vjet. Pacientët, ndërkohë, detyrohen të blejnë shumicën e barnave dhe implantëve. “Nuk kemi asnjë nga protezat e nevojshme, prandaj kemi numër të madh

pacientësh. Aktualisht, ky numër shkon mbi një mijë”, tha një ortoped për REL-in, në kushte anonimiteti. Në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare, pritja për trajtimin e problemeve me venat tejkalon dy vjet e gjysmë, për shkak të mungesës së anesteziologëve dhe vendeve për hospitalizim, ndonëse gjatë vitit janë kryer rreth 500 ndërhyrje. Në maj të këtij viti është përfunduar rinovimi i Klinikës së Onkologjisë, ku trajtohen pacientët me lloje të ndryshme të kancerit, por me vetëm 60 shtretër, edhe aty ka shpesh pritje të gjata, ose mjekim të pacientëve në salla të improvizuara. Në Klinikën e Oftalmologjisë, pritja për ndërhyrje kirurgjikale mund të zgjasë deri në nëntë muaj, varësisht nga lloji i operacionit. Haki Hoti nga Gjilani, që kreu një operacion për katarakt më 18 dhjetor, i tha REL-it se kishte pritur rreth pesë muaj për këtë intervenim.

Kritika dhe kërkesa për llogaridhënie

Në fillim të këtij muaji, Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (SHSKUK) kërkoi një raport të detajuar për listat e pritjes. Drejtori i SHSKUK-së, Elvir Azizi, tha se tashmë ekzistojnë kushte, aparatura dhe medikamente për trajtimin e rasteve dhe se është caktuar një zyrë e veçantë për përpilimin e këtij raporti. Për Bujar Vitinë, kryeredaktor i

gazetës “Shneta”, që mbulon shëndetësinë në Kosovë, situata mbetet shqetësuese. “Investimet milionëshe nuk i kanë ulur listat e pritjes. Duhet identifikim i pengesave reale dhe shpërndarje më e mirë e stafit, përfshirë orët shtesë të anesteziologëve”, tha ai për REL-in. Sipas raportit të Zyrës së Auditorit Kombëtar, vitin e kaluar, QKUK-ja ka qenë e mbingarkuar me rreth 10 mijë pacientë në lista pritjeje, ndërsa pritja mesatare e tyre ka arritur në gati tre vjet. Auditorët kanë vlerësuar se situatës i ka kontribuar mungesa kritike e personelit mjekësor, sidomos e anesteziologëve, që ka çuar në shtyrjen e operacioneve.

Një problem kronik i sistemit shëndetësor

Me ankesat për kushtet e punës dhe pagat, mbi 100 mjekë largohen nga Kosova çdo vit, sipas të dhënave të Odës së Mjekëve të Kosovës. Ministria e Shëndetësisë, e pyetur nga Radio Evropa e Lirë për listat e pritjes në QKUK, tha se menaxhimi i tyre është në kompetencë të SHSKUK-së. Ndërkohë, tollivitë në QKUK nuk shkaktohen vetëm nga pacientët, por edhe nga shoqëruesit e tyre, të cilët shpesh, në mungesë të infermierëve, kryejnë edhe punë që nuk u takojnë. Në disa reparte, mungesa e furnizimeve bazike - si sapunët apo çarçafët - mbetet gjithashtu e dukshme, duke nxjerrë në pah boshllëqe elementare në organizimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve. E, këto probleme nuk janë të reja. Ato e shoqërojnë sistemin shëndetësor të Kosovës që nga paslufta, pavarësisht investimeve të herëpashershme, ndërrimit të qeverive dhe premtimeve të vazhdueshme për reforma. Në vlerësimin e shumë profesionistëve të shëndetësisë, kjo nuk buron vetëm nga mungesa e resurseve, por edhe nga menaxhimi joefikas i kapaciteteve ekzistuese dhe planifikimi i dobët i shërbimeve.

IKShPK-ja paralajmëron rritje të rasteve me grip, apel për vaksinim sezonal

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Instituti i Shëndetësisë Publike të Kosovës ka ngritur alarmin për shtimin e rasteve me grip dhe infeksione respiratore në vend, duke theksuar se javët e fundit është vërejtur një rritje e ndjeshme e qytetarëve që kërkojnë trajtim mjekësor, përfshirë edhe raste që kanë përfunduar me hospitalizim. Sipas të dhënave të grumbulluara nga instituti, sezoni i gripit ka hyrë në një fazë intensifikimi, çka po reflektohet me rritje të ngarkesës në shërbimet

shëndetësore. Në këtë situatë, IKShPK u ka bërë thirrje qytetarëve që të tregojnë kujdes të shtuar dhe të shfrytëzojnë vaksinimin kundër gripit sezonal, duke e cilësuar atë si masën më të sigurt dhe më efektive për parandalimin e sëmundjes dhe komplikimeve që ajo mund të shkaktojë. Instituti thekson se, edhe pse sezoni i gripit ka nisur, vaksinimi vazhdon të jetë i dobishëm, pasi përhapja e virusit pritet të shtohet gjatë muajve në vijim. Po ashtu, është nënvizuar se

vaksina ndihmon në zvogëlimin e rrezikut për forma të rënda të gripit dhe ofron mbrojtje të veçantë për grupet më të ndjeshme, përfshirë të moshuarit, fëmijët, personat me sëmundje kronike, si dhe të gjithë qytetarët mbi moshën gjashtë muajsh që dëshirojnë të mbrohen nga gripi dhe pasojat e tij. IKShPK ka ftuar qytetarët që, së bashku me anëtarët e familjes, të drejtohen në qendrat e mjekësisë familjare për të realizuar vaksinimin kundër gripit sezonal.



Sllagjan Trajkoviq dënohet me dhjetë vjet burgim për krime lufte në Kosovë

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar Sllagjan Trajkoviqin me dhjetë vjet burgim për krime lufte në komunën e Vushtrrisë. Trajkoviq u dënua vetëm për një pikë të aktakuzës dhe për tri të tjera, trupi gjykues tha se nuk është vërtetuar se ai ka kryer ato veprime, raporton Betimi për Drejtësi.

Sipas vendimit, Trajkoviqit do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

Prokuroria Speciale ka mirëpritur shqiptimin e aktgjykimit dënues ndaj

Trajkoviqit, duke shtuar se mbetet e përkushtuar të ndjekë penalisht krimet e luftës në Kosovë, "me qëllim sigurimin e drejtësisë për viktimat dhe vendosjen e përgjegjësisë penale për kryerësit, në përputhje me standardet ndërkombëtare".

Aktakuza ndaj tij u ngrit më 12 korrik 2023 nga Prokuroria Speciale, pasi ai ishte arrestuar më 15 dhjetor të vitit 2022. Pas arrestimit, zyrtarët në Serbi kishin deklaruar se Trajkoviq ishte ish-pjesëtar i Policisë së Kosovës.

Krimet për të cilat Trajkoviq u

akuzua, sipas Prokurorisë Speciale, u kryen më 1998-99 në fshatin Reznik të Vushtrrisë dhe në fshatrat përreth të kësaj komune.

Sipas aktakuzës, Trajkoviq ka qenë pjesëtar i forcave policore dhe ushtarake serbe dhe "ka kontribuar në vrasje, bastisje, rrahje, maltretimit, arrestimit, torturë, trajtim në mënyrë mizore dhe çnjerëzore, mbajtja në kushte skllavërie, dëbimin të mijëra civilëve shqiptarë si dhe masat e plaçkitjes, djegies dhe shkatërrimit të shtëpive të popullsisë civile të nacionalitetit

shqiptar".

Në vitet e fundit, Kosova e ka rritur numrin e aktakuzave në mungesë për krime lufte gjatë luftës së fundit, por edhe të shqiptimit të aktgjykimeve.

Në gusht të këtij viti, Prokuroria Speciale ka dorëzuar në gjykatë një aktakuzë në mungesë kundër 21 të dyshuarve për dëbimin me forcë të më shumë se 800 mijë civilëve shqiptarë nga Kosova gjatë luftës.

Gjatë luftës në Kosovë, nga viti 1998 deri në 1999, u vranë mbi 13.000 civilë, ndërsa mijëra të tjerë u zhdukën. Afër 1.600



persona vazhdojnë të jenë të zhdukur dhe pjesa më e madhe e tyre janë shqiptarë.

Që nga përfundimi i luftës, dhjetëra persona janë dënuar për krime lufte para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

LEKU: ÇËSHTJET PRONËSORE VAZHDOJNË TË JENË NDËR MË TË NDËRLIKUARAT

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Çështjet pronësore dhe trashëgimore vazhdojnë të mbeten ndër temat më të ndjeshme dhe më komplekse për sistemin gjyqësor të Kosovës, ndërsa mungesa e dokumentacionit kadastral dhe rrethanat historike vazhdojnë të ndikojnë drejtpërdrejt në zvarritjen e proceseve gjyqësore.

Kështu ka deklaruar gjyqtari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Zenel Leku, në podcastin për të drejtat pronësore në Telegrafi me redaktoren Jehona Hulaj, ku ka theksuar se këto raste kërkojnë trajtim të veçantë dhe profesionalizëm të lartë.

"Çështjet pronësore janë çështje të ndërlikuara. Vendimmarrja shpeshherë komplikohet për shkak të mungesës së të dhënave kadastrale, pasi dihet që gjatë luftës ato janë marrë dhe janë dërguar në Serbi, gjë që edhe sot paraqet problem serioz në vendimmarrje", ka thënë Leku. Sipas tij, përkundër përpjekjeve për trajtim më efikas, gjykatat përballen me ngarkesë të madhe të lëndëve, sidomos në vitet e fundit për shkak të kontesteve të natyrës tjetër, siç janë ato të punës. "Vërehet një qasje më pozitive dhe trajtim më i shpejtë i këtyre rasteve, por



ngarkesa e madhe me lëndë të tjera, sidomos kontestet e punës, ndikon drejtpërdrejt edhe në zvarritjen e çështjeve pronësore", ka shtuar ai.

Gjyqtari i Gjykatës Supreme ka bërë të ditur se mesatarja e trajtimit të çështjeve pronësore në Kosovë sillet rreth pesë vjet, duke theksuar se po punohet që kjo kohë të zvogëlohet dhe të përputhet me standardet evropiane. "Sipas studimeve, çështjet pronësore zgjasin

mesatarisht rreth pesë vjet. Po punohet që kjo kohë të zvogëlohet dhe të jetë brenda standardeve që kërkojnë edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut", ka theksuar Leku.

Ai ka përmendur gjithashtu se mungesa e komunikimit procedural me Serbinë mbetet një nga faktorët kryesorë që pamundëson trajtimin e disa rasteve. "Ligji përcakton mënyrën e komunikimit me

palët në procedurë. Kur komunikimi është i pamundur, gjykata detyrohet të ndërpresë ose të pushojë gjykimin", ka sqaruar ai.

Duke folur për të drejtat e grave në trashëgimi, Leku ka vlerësuar se ka një trend pozitiv sa i përket vetëdijesimit dhe paraqitjes së rasteve nga gratë në gjykatë, megjithatë sfidat mbeten të pranishme. "Vërehet një trend pozitiv i paraqitjes së rasteve nga gratë

që kërkojnë realizimin e të drejtave të tyre nga trashëgimia ose pasuria e përbashkët e bashkëshortëve", ka thënë ai.

Ai ka theksuar se përjashtimi nga trashëgimia përbën shkelje serioze dhe në disa raste edhe vepër penale. "Ka raste kur trashëgimia hapet pa u njoftuar trashëgimtarët, kryesisht gratë, dhe kjo përbën shkelje serioze. Trashëgimtari nuk mbetet pa pjesën e tij dhe ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës", ka deklaruar Leku.

Leku ka nënvizuar rëndësinë e ndërtimit të praktikës unike gjyqësore, duke përmendur mendimet juridike të Gjykatës Supreme si instrument kyç për sigurinë juridike të qytetarëve. "Ndërtimi i praktikës unike është shumë i rëndësishëm për sigurinë juridike të qytetarëve. Vendimmarrje të ndryshme për rrethana të njëjta krijojnë pabarazi dhe pasiguri", ka thënë ai.

Në fund, gjyqtari i Gjykatës Supreme u ka bërë thirrje qytetarëve që të besojnë në sistemin gjyqësor. "Mesazhi im është që qytetarët të besojnë në sistemin gjyqësor. Ne jemi këtu për të bërë të gjitha përpjekjet që të realizohen të drejtat e tyre", ka përfunduar Leku.

Ngadhnjim Arrni, emërohet kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në takimin e tij të 357-të, miratoi raportin e Panelit për shqyrtimin e aplikacioneve, intervistimin, vlerësimin dhe rekomandimin e kandidatëve për pozitën e kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Anëtarët e KGJK-së, pas zhvillimit të procesit të votimit, me shumicë votash dhe një abstenim zgjodhën Ngadhnjim Arrnin kryetar të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Mandati i kryetarit, është

pesëvjeçar dhe do të filloj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ngadhnjim Arrni është gjyqtar në Departamentin Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Gjyqtari Arrni ka diplomuar në Fakultetin Juridik - Universiteti i Prishtinës në vitin 2014. Provimin e jurisprudencës e ka përfunduar në vitin 2016, ndërsa praktikën profesionale e ka mbajtur në periudhën e viteve 2014-2015 në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Nga viti 2016 deri më 2017 ka

punuar si zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore në Prishtinë përmes programit të USAID - CLE. Gjithashtu në periudhën 2018-2019 ka punuar si Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Me datë 21.01.2019 Ngadhnjim Arrni është emëruar gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Gjyqtari Arrni në janar 2024 është avancuar në



Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Special dhe më 1 shkurt ka filluar

punën si gjyqtarë në Departamenti Special, pozitë të cilën ende e mban.

SËRISH PROBLEME ME RRYMËN: PSE NUK PO STABILIZOHET SITUATA NË KOSOVË?

Përgatitjet për festat e fundvitit në Kosovë sikur e lënë gëzimin në fyt, kur duhet menduar alternativat për ngrohje e për drita, në mungesë të energjisë elektrike. Nëse për asgjë tjetër, Kosova është ndër vendet më të pasura në botë me linjit (thëngjill të butë), por duket se ky fakt nuk e zgjidh këtë problem të zvarritur vit pas viti. Cila është zgjidhja?

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Dy termocentrale të vjetra prej disa dekadash, Kosova A dhe Kosova B, e mbajnë mbi supe barrën e furnizimit me energji elektrike të mbi 1.5 milion qytetarëve të Kosovës. Për rehabilitimin e tyre, për ta rritur sigurinë e furnizimit me energji përballë rritjes së nevojës së qytetarëve për rrymë, vetëm më 2025 janë ndarë miliona euro, sipas Qeverisë në detyrë. Investime milionëshe në rrjet përmendën edhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Kompania Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike (KEDS). Megjithatë, periudha e fundvitit sikur i rrëzon të gjitha matematikat. Ulja e temperaturave atmosferike, dyndja e diasporës në Kosovë - të gjitha ndikojnë nga pak. KEDS-i u bëri thirrje qytetarëve më 22 dhjetor për kursim të energjisë në orët e pikut, për të ruajtur stabilitetin e furnizimit me rrymë - konsumi i energjisë ka arritur ditëve të fundit në mbi 1.365 megavat rrymë brenda një ore. Për shkak të ngarkesës së madhe në rrjetin e shpërndarjes pati ndërprerje të rrymës në disa qytete. Bizneset u ankuan për dëme të mëdha. Ka, po ashtu, shqetësime që reduktimet mund ta cenojnë edhe procesin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit.

Prodhimi vs. importi

Kosova arrin ta prodhojë 94 për qind të energjisë - apo rreth 800

megavat në orë - përmes djegies së thëngjillit, ndërsa sasinë tjetër e siguron nga burimet e ripërtërishme: hidrocentralet, panelet diellore dhe turbinat e erës. Ish-ministri i Energjisë i Kosovës, Ethem Çeku, thotë për Radion Evropa e Lirë se thelbi i krizës qëndron te mungesa e investimeve kapitale në sektorin e energjisë, dhe te pamundësia për të tërhequr investitorë të mëdhenj, prandaj çmimi i rrymës do të rritet vazhdimisht. "Investimet janë arna-arna. Nuk kanë mundur ta mbajnë prodhimin blloqet e Kosovës A dhe B, nuk është hapur tregu për investime private në energjinë diellore dhe të erës. Janë investime minimale". Sipas tij, paratë e shtetit janë duke shkuar kryesisht në blerje të energjisë, dhe kjo është një politikë krejtësisht e gabuar. Të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se vendi ka importuar rrymë në vlerë të rreth 248 milionë eurove në periudhën janar-nëntor 2025, ndërsa ka eksportuar në vlerë të rreth 48 milionë eurove. Importin, Kosova e ka siguruar kryesisht nga Maqedonia e Veriut, në vlerë të 114 milionë eurove, dhe nga Shqipëria, në vlerë të 94 milionë eurove, ndërsa ka importuar në vlera nga 3-4 milionë edhe nga Sllovenia, Serbia e Danimarka. Së voni, në Kosovë ka pasur akuza e raportime të shumta në media se Kosova është duke bashkëpunuar me biznesmenë serbë për blerje të rrymës përmes skemave të ndryshme, mirëpo Qeveria në detyrë i ka



hedhur poshtë të gjitha këto pretendime.

Shansi i humbur me Kosovën e Re

Më 2017, Kosova nënshkroi marrëveshje komerciale me kompaninë amerikane Contour Global, për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re. Vlera e projektit ishte 1.3 miliard euro, ndërsa kapaciteti i prodhimit të energjisë pritej të rritej për 500 megavat. Planet ishin që termocentrali të funksionalizohej më 2023, me një jetëgjatësi prej 40 vjetësh. Shoqëria civile në Kosovë dhe zëra ndërkombëtarë ishin kundër ndërtimit të një termocentrali të ri me thëngjill për shkak mjedisore. Më 2020, Contour Global u tërhoq nga projekti, duke përmendur se nuk synonte më projekte me thëngjill, si dhe për shkak të ndryshimit të udhëheqjes në Kosovë. Në pushtet, atë kohë, ishin Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, të cilat kishin shprehur shqetësime për mundësinë e shtrenjtimit të çmimit të energjisë.

Megjithatë, Çeku beson se Kosova është dashur t'i bindte me çdo çmim Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që me investitorë të fuqishëm të ndërtohej termocentrali i ri. "Ne nuk kemi alternativë tjetër, hidroja është minimale, energjia e erës është e vogël, energjia diellore është me kosto tepër të shtrenjtë, edhe pse ka ditë të mjaftueshme me diell, mirëpo bazën e zhvillimit të sektorit të energjisë është dashur ta mbajmë me linjit", thotë ai, duke përmendur se edhe shtetet evropiane kanë plane rezervë për prodhim të energjisë me thëngjill, sidomos pas nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë, e cila e rriti krizën me energjinë.

Planet e Kosovës në të ardhmen

Kosova miratoi në marsin e 2023-tës Strategjinë për energji 2022-2031. Përveç rinovimeve të termocentraleve aktuale, prioritet kanë burimet e ripërtërishme, prej të cilave pritet të gjenerohet 35 për qind

e energjisë elektrike pas 10 vjetëve. Për më tepër, Kosova nënshkroi edhe një marrëveshje për dekarbonizim - heqjen e thëngjillit nga përdorimi - deri më 2050. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës, prej vitit 2022, ka ndarë subvencione për qytetarët që blejnë pajisje eficiente për ngrohje (klima, pompa termike, kaldaja me biomasë), mirëpo ekspertët vlerësojnë se ky vendim nuk ishte menduar mirë, sepse vetëm e ka ngarkuar edhe më tepër rrjetin energjetik. "Politika e subvencioneve, herë e faturave, herë e disa çështjeve tjera, nuk janë zgjidhje të problemit. Janë mbulim i problemit", vlerëson ish-ministri Çeku. Një tjetër projekt i madh për energjinë u prezantua në prill të vitit 2024 nga Kosova dhe nga Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit e Qeverisë amerikane. Programi në vlerë të 236 milionë dollarëve parashihet ta transformojë sektorin e energjisë, pasi do të ndërtohen vende apo bateri për ruajtjen e energjisë, që ajo të shfrytëzohet më pas varësisht prej nevojave.

ZRRE U BËN THIRRJE QYTETARËVE DHE BIZNESEVE PËR KUJDES NË PËRDORIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZrRE) ka mbajtur një takim koordinues me kompanitë e licencuara në sektorin e energjisë, përkatësisht me përfaqësuesit e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) dhe Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO). Qëllimi i takimit ishte vlerësimi i sigurisë së furnizimit me energji elektrike gjatë periudhës së fundvitit, një periudhë që tradicionalisht karakterizohet nga rritje e ndjeshme e konsumit të energjisë elektrike. Gjatë takimit u diskutuan sfidat




kryesore me të cilat zakonisht përballen rrjeti energjetik në periudha festive, përfshirë ndikimin e kushteve klimatike dimërore në stabilitetin e

prodhimit dhe transmetimit; kufizimet teknike të rrjetit dhe nevoja për balancim të vazhdueshëm ndërmjet prodhimit, importit dhe

konsumit; përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare dhe funksionimin e sigurt të sistemit rajonal të energjisë; si dhe organizimin institucional gjatë periudhës së pushimeve dhe zgjedhjeve qendrore. Përfaqësuesit e ndërmarrjeve të licencuara prezantuan kapacitetet teknike dhe operative për përballimin e ngarkesave të shtuara, si dhe masat parandaluese që janë ndërmarrë për të garantuar stabilitetin e furnizimit. ZrRE ka kërkuar nga operatorët përgjegjës hartimin dhe përditësimin e planeve të menaxhimit të gjendjes, përfshirë skenarë të mundshëm dhe planifikim paraprak të masave, në

rast të situatave të paparashikuara. ZrRE u bën thirrje qytetarëve dhe bizneseve që gjatë kësaj periudhe të tregohen të kujdesshëm dhe racionalë në përdorimin e energjisë elektrike. "Kursimi i energjisë, veçanërisht në orët e kërkesës maksimale (pikut), kontribuon drejtpërdrejt në stabilitetin e sistemit dhe në sigurinë e furnizimit të vazhdueshëm për të gjithë konsumatorët. Zyra e Rregullatorit për Energji do të vazhdojë të monitorojë nga afër situatën dhe të bashkëpunojë ngushtë me të gjithë operatorët e sektorit për të garantuar furnizim të sigurt dhe të qëndrueshëm me energji elektrike", thuhet në njoftimin e ZrRE-së.

MBRETI YNË, PRIFTI YNË, FEUDALI YNË - SI PO NA KTHEN INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË MESJETË



Nga: Joseph de WECK /
The Guardian

Këtë verë, u përballa me trafik në rrugët përvëluese të Marsejës. Në një kryqëzim, mikështa ime në ulësen e pasagjerit më tha të kthehesha djathtas drejt një vendi të njohur për supën e peshkut. Por, aplikacioni i navigimit Waze na udhëzonte të vazhdonim drejt. I lodhur, dhe me Renault-n që ndihej si një saunë me rrota, ndoqa këshillën e Waze-it. Pak çaste më vonë, mbetëm të bllokuar në një kantier ndërtimi.

Një moment i parëndësishëm, mbase. Por, një i tillë që përmbledh ndoshta pyetjen përcaktuese të epokës sonë, ku teknologjia prek thuajse çdo aspekt të jetës: kujt i besojmë më shumë - njerëzve të tjerë dhe instinkteve tona, apo makinerisë?

Filozofi gjerman Immanuel Kant, e përkufizoi epokën e Iluminizmit si “daljen e njeriut nga papjekuria e vetëshkaktuar”. Papjekuria, shkroi ai, është “paaftësia për të përdorur arsyen pa udhëheqjen e dikujt tjetër”. Për shekuj me radhë, ky “tjetri” që drejtonte mendimin dhe jetën e njeriut ishte shpesh prifti, monarku apo feudali - ata që pretendonin se vepronin si zëri i Zotit në Tokë. Në përpjekjet për të kuptuar fenomenet natyrore - pse shpërthejnë vullkanet, pse ndryshojnë stinët - njerëzit i drejtoheshin Zotit për përgjigje. Në formësimin e botës shoqërore, nga ekonomia te dashuria, feja na shërbente si

udhërrëfyes.

Sipas Kantit, njerëzit gjithmonë kishin aftësinë për të arsyetuar. Thjesht, nuk e kishin gjithmonë guximin për ta përdorur atë. Por, me Revolucionin Amerikan dhe më vonë atë Francez, një epokë e re po agonte: arsyeja do të zëvendësonte besimin dhe mendja njerëzore, e çliruar nga autoriteti, do të bëhej motori i përparimit dhe një bote më morale. “Sapere aude” ose “Guxo të përdorësh mendjen tënde” - i nxiste Kanti bashkëkohësit e tij.

Dy shekuj e gjysmë më vonë, mund të pyesim nëse po rrëshqasim sërish në papjekuri. Një aplikacion që na thotë se cilën rrugë do të marrim është një gjë. Por, inteligjenca artificiale [IA] rrezikon të bëhet “tjetri” ynë i ri - një autoritet i heshtur që udhëheq mendimet dhe veprimet tona. Rrezikojmë të heqim dorë nga guximi i fituar me mund për të menduar - dhe këtë herë jo ndaj perëndive apo mbretërve, por ndaj kodit.

ChatGPT u lansua vetëm tre vjet më parë dhe, megjithatë, një sondazh global i publikuar në prill zbuloi se 82 përqind e të anketuarve e kishin përdorur IA-në gjatë gjashtë muajve të fundit. Qoftë kur vendosnin të përfundonin një marrëdhënie apo për të votuar, njerëzit u drejtoheshin makinerive për këshilla. Sipas OpenAI-së, 73 përqind e kërkesave të përdoruesve lidhen me tema që nuk kanë të bëjnë me punën. Edhe më intriguese, sesa varësia jonë nga gjykimi i IA-së në jetën e përditshme, është ajo që ndodh kur e lejojmë atë të flasë

në emrin tonë. Tani, shkrimi është ndër përdorimet më të zakonshme të ChatGPT-së, menjëherë pas kërkesave praktike si “bëje vet” apo këshillat për kuzhinë. Autorja amerikane Joan Didion ka thënë njëherë: “Shkruaj vetëm për të zbuluar se çfarë mendoj”. Por, kur ndalojmë së shkruari? A ndalojmë së zbuluari?

Ajo që shqetëson është se disa prova sugjerojnë se përgjigjja mund të jetë një po. Një studim i Institutit të Teknologjisë së Masaçusetsit [MIT] përdori elektroencefalografi (EEG) për të monitoruar aktivitetin e trurit të eseistëve që kishin qasje në IA, në motorë kërkimi si Google, ose nuk kishin fare ndihmë. Ata që mund të mbështeteshin tek IA-ja shfaqën aktivitetin më të ulët kognitiv dhe kishin vështirësi në citimin e saktë të punës së tyre. Më shqetësuese ishte se, pas disa muajsh, pjesëmarrësit që përdorën IA-në u bënë gjithnjë e më dembelë, duke kopjuar blloqe të tëra teksti në esetë e tyre.

Studimi është i vogël dhe jo i përsosur, por Kanti do ta kishte njohur këtë model. “Dembelia dhe frika”, shkroi ai, “janë arsye për një pjesë kaq e madhe e njerëzve ... mbeten në papjekuri gjatë gjithë jetës, dhe pse është kaq e lehtë që të tjerët të vendosen si kujdestarë të tyre. Është kaq e lehtë të jesh i papjekur”.

Sigurisht, interesantja e IA-së qëndron te rehatia që ofron. Kursen kohë, shmang përpjekjen dhe - ç’është më e rëndësishmja - ofron një mënyrë të re për të hequr përgjegjësinë nga vetja. Në

librin e tij të vitit 1941, Arratisje nga liria, psikanalisti gjerman Erich Fromm argumentoi se ngritja e fashizmit mund të shpjegohej pjesërisht nga dëshira e njerëzve për të dorëzuar lirinë e tyre në këmbim të sigurisë së nënshtrimit. IA-ja ofron një mënyrë të re për të dorëzuar atë barrë të mendimit dhe vendimmarrjen personale.


Tërheqja më e madhe e IA-së është se mund të bëjë gjëra që mendja jonë nuk mundet - të përpunojë oqeane me të dhëna dhe ta bëjë këtë me shpejtësi të paprecedentë. Ulur në makinë në Marsejë, kjo ishte, në fund të fundit, arsyeja pse zgjedha t’i besoja makinerisë dhe jo shoqes time (një vendim të cilin ajo e mori si fyerje). Me gjithë qasjen e saj në të dhëna, mendova unë, sigurisht që aplikacioni duhet ta dijë më mirë.

Problemi është se IA-ja është një kuti e zezë. Ajo prodhon dije, por pa e thelluar domosdo kuptimin njerëzor. Ne nuk e dimë realisht si arrin në përfundimet e veta - edhe vetë programuesit e pranojnë këtë. Dhe, as nuk mund ta verifikojmë arsyetimin e saj sipas kritereve të qarta e objektive. Kështu që kur ndjekim këshillat e IA-së, nuk udhëhiqemi nga arsyeja. Po rikthehemi në mbretërinë e besimit. In dubio pro machina - kur dyshon, beso makinën - mund të bëhet parimi ynë udhëheqës në të ardhmen. IA-ja mund të jetë aleate e fuqishme e njerëzve në kërkimin racional. Mund të na ndihmojë të shpikim ilaçe, të na çlirojë nga “punët e kota” ose

nga detyrat e taksave - gjëra që kërkojnë pak mendim dhe ofrojnë edhe më pak kënaqësi. Aq më mirë. Por, Kanti dhe bashkëkohësit e tij nuk e mbështetën arsyen mbi besimin vetëm që njerëzit të mund të sistemonin më mirë ose të kishin më shumë kohë të lirë. Mendimi kritik nuk kishte të bënte vetëm me efikasitetin - ishte praktikë e lirisë dhe emancipimit njerëzor.

Mendimi njerëzor është i çrregullt dhe plot gabime, por na detyron të debatojmë, të dyshojmë, të testojmë ide kundrejt njëra-tjetrës - dhe të njohim kufijtë e të njohjes tonë. Ndërton vetëbesimin, si individualisht ashtu edhe kolektivisht. Për Kantin, ushtrimi i arsyes nuk ishte kurrë vetëm për dije; ishte për t’ua mundësuar njerëzit të bëheshin veprues të jetës së tyre dhe të rezistojnë ndaj dominimit. Ishte për të ndërtuar një bashkësi morale të mbështetur në parimin e përbashkët të arsyes dhe debatit dhe jo në besimin e verbër.

Me gjithë përfitimet që sjell IA-ja, sfida është kjo: si mund të shfrytëzojmë premtimin e saj për inteligjencë mbinjerëzore, pa cenuar arsyen njerëzore - gurin themeltar të Iluminizmit dhe të vetë demokracisë liberale? Kjo mund të jetë një nga pyetjet më përcaktuese të shekullit XXI. Dhe, është një pyetje që nuk duhet t’ia delegojmë makinës. /Telegrafi/



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

“Sport Bild”: Bayerni vazhdon të jetë i interesuar për Fisnik Asllanin

BAYERN, 26 DHJETOR - Bayerni vazhdon të jetë i interesuar për sulmuesin e Kosovës, Fisnik Asllani, i cili po luan një sezon të hatashëm në Bundesligën gjermane, me Hoffenheimin. Me gjashtë gola e dy asistime, Asllani vlerësohet lartë nga hierarkia e Bayernit, që edhe

publikisht e kanë pranuar pëlqimin për të, derisa vet futbollisti me vlerën prej 30 milionë eurosh në transfermarkt, vlerësohet si futbollisti më i shtrenjtë kosovar. Klubi i tij megjithatë, e vlerëson 50 milionë euro, si shumë përfundimtare për

largimin e tij, pasi përveç Bayernit, të interesuar për të mbetet edhe Barcelona, Dortmundi e Chelsea. 23-vjeçari shihet si një nga dëshirat e klubit bavarez, pasi ka lindur në Berlin, e njëj mirë futbollin gjerman dhe ligën dhe vlerësohet si talent i madh por

sipas gazetarit të “SportBild”, Christian Falk, ka një problem për transferimin e Asllanit te Bayerni. Synimet e klubit nga Muncheni për vazhdimin e kontratës me Harry Kane, mund të prishin punë, megjithëse Asllani, shihet si e ardhmja e sulmit bavarez.



DUKA: DUHET TA KEMI NJË KOMBËTARE

TIRANË, 26 DHJETOR - Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF), Armand Duka, është i mendimit që shqiptarët duhet të kenë vetëm një kombëtare të futbollit. I pari i futbollit shqiptar i ftuar në emisionin “Mirëmbërëma yje”, nga Arbana Osmani, në një intervistë të gjerë ka folur edhe për temën e shumë diskutuar, por se e ka pranuar që kjo është diçka e vështirë, por më mirë për të dyja vendet.

“Ne duhet të kemi një Kombëtare. Por kjo nuk varet as nga unë dhe as nga ti. Unë kështu e mendoj, por nuk kemi gjë në dorë. Për sa kohë jemi dy shtete më një komb, do kemi dy ekipe, dy kampionate. Nëse jemi bashkë jemi një vend më i



madh, kemi potencial më shumë, jemi treg më i madh. Në të gjitha këndvështrimet

është më mirë mendoj, jo vetëm në futboll”, ka thënë Duka.

Në pyetjen se cila kombëtare është më e mirë, Shqipëria apo Kosova, Duka ka zgjedhur natyrshëm kuqezinjtë.

“Ne jemi më të mirë se Kosova. Por Kosova ka futbollistë të mirë, është në ‘play-off’. Në një histori kaq të shkurtër, me kaq pak eksperiencë të shkosh në ‘play-off’ është një sukses i madh dhe është një moment që duhet ta jetojnë dhe të vazhdojnë ta synojnë Botërorin”, ka thënë Duka.

Ai e ka pranuar se ka një problem me “Tifozat Kuqezi”, por që sipas tij dëshiron një nivel dhe një ambient më të kulturuar në stadium.

Gjatë bisedës, Duka është ndalur te puna e përditshme në krye të Federatës, te

progresi i futbollit kombëtar dhe ambicia për kualifikimin e Kombëtares shqiptare në Kampionatin Botëror, një objektiv që, sipas tij, mbështetet në punën e vazhdueshme dhe potencialin real të skuadrës.

“Për të qenë brenda kornizave të profesionit tim, ne kemi 25% probabilitet, sepse jemi katër skuadra me të njëjtin nivel dhe të katërta kemi nga 25%. Unë kam shumë besim dhe e kam pasur gjithmonë. Besimi im është real, nuk është thjesht dëshirë. Është real për nga niveli dhe skuadra që kemi, për atë çfarë ne kemi bërë, futbollistët në fushë i kanë të gjitha mundësitë”, ka thënë Duka.

GALLAPENI VIZITON “JETIMAT E BALLKANIT”, NDAN DHURATË PËR HALIL KASTRATIN



SUHAREKË, 26 DHJETOR - Futbollisti i Kosovës, Dion Gallapeni ka vizituar Shtëpinë e të Moshuarve “Jetimat e Ballkanit”. Ai ka takuar humanistin Halil Kastrati, ku i ka dhuruar edhe dy fanella, atë të Kosovës dhe të skuadrës polake, Widzew Lodz, ku luan aktualisht.

Me këtë rast, Kastrati ka falënderuar Gallapenin dhe i ka uruar suksese në Kombëtare dhe klubin ku luan. “Talent,

modesti dhe zemër, krenari për Kosovën! Sot patëm kënaqësinë të mirëpresim në Shtëpinë e të Moshuarve Jetimat e Ballkanit futbollistin e ri dhe premtues të kombëtares sonë, Dion Gallapeni, së bashku me menaxherin e tij. Takim i mbushur me respekt, pozitivitet dhe mirësi, aty ku sporti dhe humaniteti bashkohen dhe japin shpresë për gjeneratat që vijnë. Dion, faleminderit nga zemra për

vizitën, për kohën që ndave dhe për fanellat e tua të dhuruara si kujtim dhe motivim! Ato do të kenë vend të veçantë në arkivin tonë të mirënjohjes. Urojmë që çdo ndeshje të të sjellë rritje, suksese dhe krenari për ju dhe vendin tonë. Vazhdo me punë, disiplinë dhe zemër sepse e ardhmja është e atyre që nuk ndalen kurrë! Zoti kurrë mos të humbë!”, ka shkruar Kastrati në “Facebook”.

Hetimet në skandalin e basteve në futbollin turk, arrestohen 14 futbollistë

ANKARA, 26 DHJETOR - Skandali i basteve në futbollin turk po zgjerohet me shpejtësi. Pasi janë bërë disa arrestime të tjera, ky hetim ka përfshirë tani figura të larta të futbollit, duke përfshirë ish-zëvendëspresidentin e Galatasaray, Erden Timur.

Sipas raporteve nga mediat turke, autoritetet kanë lëshuar urdhra arresti për 29 persona, ndër ta edhe Timur, i cili dikur mbante një pozicion të

rëndësishëm në klubin e njohur të Stambollit. Pjesë e operacionit ishin gjithashtu 14 futbollistë, të cilët akuzohen se kanë vënë baste për rezultatin e ndeshjeve. Hetimet kanë zbuluar se në llogaritë bankare të Timurit janë identifikuar transaksione financiare të dyshimta, të cilat sugjerojnë se ai ka qenë i përfshirë në aktivitetet e basteve ilegale. Ky skandal ka çuar në përfshirjen e futbollistëve dhe personave të tjerë të lidhur

ngushtë me futbollin në Turqi. Ndërkohë, një person tjetër që kishte kryer një krim tjetër tashmë është i burgosur, ndërsa kërkimi për katër të dyshuar të tjerë vazhdon. Ky skandal ka tronditur thellë futbollin turk, i cili është tashmë në qendër të një hetimi të madh. Federata turke e Futbollit (TFF) publikoi në fund të tetorit akuza të rënda, sipas të cilave 152 gjyqtarë janë të përfshirë në baste të paligjshme. Për pasojë, janë

ndërmarrë masa për pezullimin e më shumë se 1000 lojtarëve dhe 149 gjyqtarëve, duke përfshirë edhe individë nga liga e parë, Süper Lig. Në mesin e të përfshirëve janë lojtarë nga ekipet më të mëdha turke si Galatasaray, Fenerbahçe, Beşiktaş dhe Trabzonspor.

Ky skandal ka krijuar një krizë të madhe për futbollin në Turqi, duke vënë në pikëpyetje integritetin e ligës dhe të



sistemit të gjykitimit. Pavarësisht se hetimet janë ende në zhvillim, ky skandal ka bërë që shumë figura të njohura të futbollit, si lojtarë dhe zyrtarë, të përballen me pasojat e veprimeve të tyre të paligjshme.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Auto Sallon Te Arbeni” SH.P.K. pronar Ferki Sokoli me seli në Vushtri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811421677 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Auto Sallon Te Arbeni” D.O.O. Ferki Sokoli Vuqitern donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811421677 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Auto Sallon Te Arbeni” L.L.C. with owner Ferki Sokoli with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 811421677 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

-“Focus” SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811054387.

- Leonor Osmanaj shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Giakovë.

- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Pjeter Bogdani" Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.I. me nr. Unik: 811133719.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greicevci".

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.


- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, bane-
sa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet
me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy
muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për infor-
mata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

